



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700082/6

Tiranë ____/____/2017

Lënda: *Rekomandohet zbatimi i legjislacionit që përcakton rregullat për kufizimin fizik të të burgosurve që me veprimet e tyre tentojnë të dëmtojnë veten ose të tjerët*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**
Z. Miklovan KOPANI

TIRANË

Drejtorit të IEVP Fier
Z. Shkëlzen VALBONA

FIER

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë të dënuarit B. P. dhe A. M., të cilët pretendonjnë se: ata janë mbajtur për tre ditë të kufizuar me fasheta plastike, pranga dhe skafandër në kokë në krevatin e dhomës së veçimit; gjatë qëndrimit të prangosur nuk i është dhënë mundësia që të ushqehen; B. P. është dhunuar fizikisht nga punonjës të policisë së IEVP Fier. Këto veprime janë kryer pas një ngjarje të ndodhur në dhomën e tyre në datën 17.01.2017. Ankuesit pranojnë se kanë kryer veprime të dhunshme në këtë datë pas refuzimit të kërkesës së tyre për të lëvizur në një sektor tjetër dhe provokimit që i është bërë nga një i burgosur tjetër. A. M. ka goditur me grusht një bashkëvuajtës të sektorit dhe ka dëmtuar disa sende të dhomës ndërsa B. P. ka dëmtuar dritaren e dhomës së veçimit.

Për verifikimin e ankesës janë kryer disa veprime hetimore si: marrja e deklarimeve me shkrim nga ankuesit; kqyrja e dhomave të veçimit ku kanë qëndruar të dënuarit; kqyrja e librit të aktivitetit 24-orësh të sektorëve ku janë kryer veprime me të dënuarit; marrja e shpjegimeve verbale nga stafi mjekësor; marrja e shpjegimeve verbale nga punonjës të policisë; administrimi i dokumentave të IEVP

Peqin që pasqyrojnë ngjarjen dhe të akt ekspertimit mjeko-ligjor të të dënuarit B. P.

Nga analiza në tërësi e veprimeve hetimore të kryera arrijmë në përfundimin se:

Pretendimi i të dënuarit B. P. se ndaj tij është ushtruar dhunë fizike nuk provohet pasi, koha e shkakimit të shenjave të gjetura në trupin e tij nuk përputhet me kohën kur ky i dënuar pretendon se ato janë shkaktuar. Eksperti mjeko-ligjor ka kryer ekzaminimin mjeko-ligjor në datën 25.01.2017 dhe ka arritur në përfundimin se ekimozat e vërejtura në trupin e të dënuarit B. P. janë shkaktuar jo më parë se tre-katër ditë nga data e ekzaminimit ndërsa i dënuari ka deklaruar se dhuna ndaj tij është ushtruar në ditën e parë që ai është dërguar në dhomën e veçimit që sipas dokumentacionit është data 17.01.2017.

Për sa i përket pretendimit të dy të dënuarve se, ata kanë qëndruar të prangosur për tre ditë, kjo provohet nga shënimet e lëna në raport shërbim dhe në Librin e aktivitetit 24-orësh të ambjentit të veçimit. Në këtë Libër është mbajtur shënim se dy të dënuarit janë prangosur për arsye sigurie, sepse ata shfaqeshin të dhunshëm, kanë dëmtuar dritaren e dhomës dhe njëri prej tyre B. P. ka tentuar të kapë telat e korentit (B.P është i diagnostikuar me probleme të shëndetit mendorë). Nga shënimet nuk mund të kuptohet nëse gjatë tre ditëve të dënuarit kanë qëndruar gjithë kohën të prangosur apo vetëm në interval kohe të caktuar, pasi punonjësi i shërbimit nuk ka specifikuar veprimet që grupi i sigurisë ka kryer me ata. Stafi mjekësor nuk ka monitoruar kufizimin fizik të B.P dhe A.M siç pohohet nga vetë ata dhe siç rezulton nga pasqyrimi i veprimeve në regjistra. Vlerësimi i rrezikshmërisë së veprimeve të dy të dënuarve është bërë vetëm nga punonjësit e policisë, të cilët kanë vendosur për prangosjen e tyre dhe kohëzgjatjen e prangosjes. Stafi mjekësor ka paqyruar në Librin e shërbimit infermieror vetëm vizitën e kryer ndaj B.P dhe A.M pasi ata janë sjellë në ambjentin e Spitalit nga punonjësit e policisë.

Në Zyrën tonë janë regjistruar edhe më parë raste të ngjashme, kur një i burgosur kryen veprime për tu vetdëmtuar ose për të dëmtuar të tjerët. Këto raste nuk monitorohen nga stafi mjekësor por, situata lihet vetëm në vlerësimin e punonjësve të policisë, të cilët i kufizojnë me pranga në krevat të burgosurit dhe i vendosin atyre skafandër në kokë.

Legjislacioni në fuqi përcakton se, një nga rastet e përdorimit të mjeteve kufizuese është ai kur një i burgosur kryen veprime për tu vetdëmtuar apo për të dëmtuar të tjerët ose pronën. Kufizimi në këto raste bëhet me urdhër të drejtorit të IEVP-së, i cili duhet të informojë mjekun e burgut dhe të raportojë ne DPBurgjeve. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe i burgosuri duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor gjatë shtrëngimit fizik. Drejtori i IEVP-së në konsultim me mjekun vlerëson rregullisht, nëse përdorimi i mjeteve kufizuese duhet të vazhdojë ose jo. Stafi mjekësor duhet të bëjë vlerësimin e riskut të të burgosurit, të përcaktojë kohëzgjatjen e kufizimit dhe të dokumentojë rastin në kartelën klinike dhe në regjistrin e kufizimit fizik. Përgjegjësi i sektorit të sigurisë, cakton një punonjës përgjegjës për kujdesin dhe mbikëqyrjen e të burgosurit. I burgosuri duhet të marrë ushqim dhe pije në intervale të rregullta kohore. Të gjitha detajet për situatën duhet të shënohen në regjistër.

(neni 27, 28 dhe 29 i Ligjit Nr.44/2012 “Për shëndetin Mendorë”; Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.586, datë 30.10.2013 “Standartet e kufizimit fizik në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër”; neni 45 i Ligjit Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”; neni 57 dhe 58 i Ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; neni 123 i Rregullores së përgjithshme të Burgjeve”; Udhëzuesi administrativ në sistemin e burgjeve “Mbi përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik, përdorimi i dhomës së veçimit, mjekimi i pavullnetshëm” i punuar nga DPBurgjeve).

Legjislacioni për shëndetin mendor parashikon se: kufizimin fizik i personave me çrregullime të shëndetit mendor duhet të zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër; kufizimi duhet të autorizohet nga mjeku psikiatër; pajisjet e kufizimit fizik duhet të jenë të veçanta. Çfarë është konstatuar nga hetimi i rasteve? Nga hetimi i rasteve është konstatuar se, personat që kryejnë veprime për të dëmtuar veten, të tjerët ose pronën jo gjithmonë janë të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendorë, siç është edhe një prej të dënuarve të ngjarjes së lartpërmendur. Të burgosurit, për të cilët lind nevoja të kufizohen fizikisht janë duke vuajtur dënimin në një IEVP jo të specializuar me shtretër. Pothuaj të gjitha IEVP-të nuk kanë në organikë mjek psikiatër. Ngjarja, për të cilën kërkohet të kryhet kufizimi fizik, mund të ndodhë në një orar kur mjeku i IEVP-së nuk është me shërbim ose nuk ndodhet në institucion. Megjithatë legjislacioni i burgjeve e lejon përdorimin e prangave për të kufizuar fizikisht të burgosurin, legjislacioni i shëndetit mendor kërkon që të përdoren mjete të veçanta kufizimi. Nga hetimi në vend në IEVP dhe në Spitalet Psikiatrike civile ka rezultuar se: asnjë IEVP nuk ka dhomë izolimi; asnjë Spital Psikiatrik Civil nuk ka mjete të veçanta të kufizimit fizik; vetëm Spitali Psikiatrik “Ali Mihal” Vlorë ka dhomë izolimi, e cila nuk është sipas standarteve; vetëm IEVP Krujë ka mjete kufizimi të veçantë (copë1).

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

J U R E K O M A N D O J M Ë:

- Trajnimin e punonjësve të IEVP-ve për tu njohur me procedurat e kufizimit fizik;
- Analizimin e këtij rasti dhe përgjithësimin i tij në të gjitha IEVP-të;
- Blerjen e mjeteve të veçanta të kufizimit fizik në sasi të mjaftueshme për të gjithë IEVP-të dhe blerjen e të paktën një shtrati dhe një karrige kufizuese për çdo IEVP;

- Pasqyrimin në regjistrin e aktivitetit 24-orësh të të gjitha veprimeve që kryhen në regjim si dhe pasqyrimin e detajuar të veprimeve që kryhen me të burgosurit e kufizuar fizikisht.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI